



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE LEGJISLACIONIT

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVILË
LËVIZJE PARALELE, PËR NGRITJEN NË DETYRË
DHE PËR KANDIDATË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT TË ARSIMIT DHE KULTURËS NË DREJTORINË E MBROJTJES SOCIALE, ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTEVE

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Bashkia Patos shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në shërbimin civil për pozicionin:

një vend në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit dhe Kulturës në Drejtorinë e Mbrojtjes Sociale, Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, kategoria e pagës III-3.

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë ku mund të marrin pjesë për konkurim edhe kandidatët jashtë shërbimit civil.

Për procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë.

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

27/04/2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

04/05/2026

• Përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës së mësipërme:

1. Harton planet mujore dhe vjetore të punës, të gjitha detyrat që i dalin Sektorit sipas disiplinave përkatëse të fushës së kulturës dhe arsimit, ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe bën analizën në nivel sektori, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga programet vjetore dhe periodike të miratuara;
2. Bën shpërndarjen e punës dhe çështjeve që i adresohen Sektorit dhe ndjek, kontrollon punën që bëhet nga punonjësit në afatet e caktuara;
3. Zbaton, ndjek dhe bashkërendon plotësimin e të gjitha detyrave të ngarkuara sipas rastit, nga Drejtori i Drejtorisë
4. Bashkëpunon me drejtori dhe sektorë të tjerë për sigurimin e ushqimit, ujit, ngrohjes dhe energjisë elektrike, të kopshteve dhe çerdhes sipas fondeve të buxhetit vjetor.
5. Punon për administrimin dhe gjallërimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit të Patosit dhe Njësisë Administrative Zharrëz e Ruzhdie, në përputhje me politikat e Bashkisë me një fokus të veçantë mbi aktivitetet rinore.
6. Menaxhon, përzgjedh dhe vlerëson projektet e ndryshme artistike, të cilat financohen nga Bashkia e Patosit.
7. Përgatit të gjithë materialin e duhur për një projekt kulturor (shkresa përcjellëse, program pune, kërkesë organizimi, preventiv/specifikime teknike, situacion,) dhe e ndjek atë deri në financimin e projektit.
8. Organizon veprimtaritë kulturore që përfshijnë: festa lokale, festa kombëtare dhe zyrtare, ceremoni të përcaktuara nga Ceremoniali i Shtetit, probleme të Trashëgimisë Kulturore.
9. Mundëson projekte të përbashkëta me institucionet artistike profesionale, projekte të përbashkëta me grupe amatore, projekte artistike në mjedise të hapura publike, projekte artistike në nivel lokal, krijon formacione në vartësi të Bashkisë etj.
10. Organizon dhe kontakton me familjet e dëshmorëve, patriotëve, OJQ-të, Komitetin e Veteranëve etj.
11. Organizon kontaktet dhe bashkëpunimin me Qarkun, Bashkitë, Njësitë Administrative dhe institucioneve të tjera për organizim veprimtarish.
12. Raporton tek eprori direkt për çdo problem që del gjatë punës.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotëroj diplomë të nivelit të Bachelor, Master Profesional ose Shkencor në Shkenca Sociale ose Ekonomike.

(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, diploma Bachelor dhe Master Shkencor duhet të jene në të njëjtën degë).

- b. Të kenë përvojë në punë mbi 3 (tre) vite.
- c. Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter.
- d. Njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Fotokopje të aktit të konfirmimit të statusit të nëpunësit civil.
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 27.04.2026.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.04.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- d. Njohuritë mbi ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", në Republikën e Shqipërisë.
- e. Njohuritë mbi ligjin Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën” i ndryshuar;

- f. Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzet”;
- g. Njohuritë mbi ligjin nr.8576,datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.
- h. Njohuritë mbi ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data dhe vendi i konkurimit do të njoftohet konkurrenteve.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin e “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

NGRITJA NË DETYRË

2

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet ngritjes në detyrë, ku mund të marrin pjesë për konkurim edhe kandidatët jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat pranë Bashkisë Patos.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorise të ulët drejtuese, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë, si edhe kandidatët jashtë shërbimit civil, sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotëroj diplomë të nivelit të Bachelor, Master Profesional ose Shkencor në Shkenca Sociale ose ekonomike

(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, diploma Bachelor dhe Master Shkencor duhet të jene në të njëjtën degë).

- b. Të kenë përvojë në punë mbi 3 (tre).
- c. Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter .
- d. Njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.
- e. Të ketë njohuri te një gjuhe te huaj.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun :
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c. Fotokopje të diplomës dhe listën e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që nuk ke marrë masë disiplinore në fuqi.
- i. Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv
- j. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (Jashtë Shërbimit Civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

Të kenë mbaruar studimet e larta universitare në Shkenca Sociale ose Ekonomike.

Kandidatët (Jashtë Shërbimit Civil) duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;**
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);**
- ç- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);**
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);**
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;**
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.**
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;**

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 04.05.2026.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **05.05.2026**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorsë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- i. Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- j. Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- k. Njohuritë mbi ligjin nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- l. Njohuritë mbi ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", në Republikën e Shqipërisë.
- m. Njohuritë mbi ligjin Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën” i ndryshuar;
- n. Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzet”;
- o. Njohuritë mbi ligjin nr.8576,datë 03.02.2000 “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”.
- p. Njohuritë mbi ligjin nr. 9616, datë 27.09.2006 “Për librin në Republikën e Shqipërisë”.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen përkatësisht:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;

2.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë e mesme drejtuese, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë e mesme drejtuese - për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, - datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 15/05/2026.

DREJTOR
Irisi Xhelaj